



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA DRENASIT DRENASIT MUNICIPALITY			
Pranuar 16 / 01 / 2019			
Nj. Orig.	Numër	Shtojca	Vlera
01	900/01-	2621	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit

SHPALLJE PUBLIK

Mundësi angazhimi të praktikantëve në Komuna për Eficiência të Energjisë me pagesë nga buxheti i projektit me GIZ-in

Asociacioni i Komunave të Kosovës në kuadër të bashkëpunimit me partneret në projekte të ndryshme për qeverisjen lokale, në mbështetje të GIZ-it është duke zbatuar projektin “Ndërtimi i kapaciteteve të komunave të Kosovës në fushën e menaxhimit të energjisë komunale”.

Qellimi i projektit është angazhimi i praktikantëve për grumbullimin dhe futjen e të dhënave në softuer në mënyrë që të vazhdoj me tutje zhvillimi i Planit të Veprimit Komunal për Eficiencën e Energjisë (MEEAP) në mënyrë që t’u ndihmohet Menaxherëve për Energji/Zyrtar Komunal për Eficiencë të Energjisë në këtë drejtim.

Projekti ka paraparë angazhimin e një (1) Praktikanti në Komunën e Drenasit për një periudhë dymujore.

Pagesa parashihet të jetë 200 Euro në muaj (përfshirë të gjitha taksat e aplikueshme në Kosovë) dhe do të bëhet nga AKK-ja – nga buxheti i projektit me GIZ-in.

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore të praktikantit do të jenë:

- Futjen dhe procesimin e të dhënave në Sistemim e Menaxhimit të Energjisë;
- Mbështesë menaxherin komunal për energji në aktivitetet e ndërlidhura me procesimin e të dhënave për hartimin e Planit të Veprimit Komunal për Eficiencën e Energjisë;
- Bashkëpunimi me departamentet përgjegjëse në komuna për të siguruar informacionin e kërkuar në lidhje me konsumin e energjisë në ndërtesat publike dhe ndiçimit rrugor;
- Mbështesë menaxherin për energji në përmbushjen e detyrave të tyre lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të energjisë;
- Detyrat tjera sipas kërkesës/nevojës së paraqitur.

Kualifikimet, aftësitë dhe përvoja e kërkuar

- Të ketë Diplomë pasuniversitare ose të paktën diplomë Bachelor në fushën e inxhinierisë apo fushat tjera të cilat ndërlidhen me objektivat e projektit/programit (e preferueshme është e inxhinierisë teknike dhe shkencat kompjuterike).
- Përvoja paraprake në projekte në fushën e eficiencës së energjisë dhe ajo në mbledhjen dhe procesimin e të dhënave do të konsiderohet përparësi.

Njohuri /shkathtësi/pregaditje tjera

- Njohuri të shkëlqyera në kompjuter, shkrim, komunikim dhe aftësi prezentimi;
- Të jetë i/e mirë organizuar;
- Të ketë aftësi hulumtuese;
- Të ketë aftësi për të punuar në grup;
- Të jetë i gatshëm të marrë përgjegjësi të tjera, gjithmonë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e fushëveprimit;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze dhe gjuhëve kombëtare;
- Aplikantët duhet paraqitur CV dhe Letër Motivuese;

Lokacioni

- Zyret do të jenë të vendosura në komunat përkatëse
- Praktika do të zgjasë dy muaj
- Praktika është me orar të plotë 8 orë në ditë , 40 orë në javë)

Shpallja mbetet e hapur 7 ditë nga dita e publikimit në Web faqën e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

Të interesuarit dokumentacionin e dorëzojnë në zyrën pritëse, kati i parë, sporteli nr.10,11,12 në Drenas çdo ditë pune nga ora 8.00 deri në ora 16.00.

Drenas, 16/01/2019